



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 02/11

Prishtinë, më 18.03.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza - Ministër i Financave, Alexander Beetz, Juergen Schatz, Ramadan Islami, Teki Shala dhe Njomza Ilazi nga GIZ si dhe monitorues nga Zyra e Presidentit, KDI dhe USAID.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës. Ajo propozoi që në të ndryshme të bëhet diskutimi në komision për mënyrën se si t'i qasen çështjes së dëgjimeve buxhetore me agjencione të pavarura. Më pas konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011

Kryetari, theksoi se projektbuxheti është përgatitur në bazë të tregueseve makroekonomikë që i paraprinë hartimit të buxhetit, përmban pjesën tekstuale sipas së cilës bëhet ndarja e mjeteve dhe rrjedha e menaxhimit të tyre, si dhe pjesa tabelare. Në pjesën tabelare vërehen rritje të të hyrave prej 12.3 %. Kjo rritje ka ardhë si rezultat e rritjes së të hyrave në kufij, të hyrave të brendshme dhe të hyrave jotatimore. Në këtë pjesë vërehet poashtu se fondet janë kanalizuar për politikën që janë shpallur si prioritete në programin e Qeverisë. Sa i përket shpenzimeve ato janë 19.3 % më të larta se vitin e kaluar, në sajë të të cilave është bërë një mbështetje e shtuar financiare për punonjësit e sektorit publik dhe për kategoritë sociale. Është bërë përpjekje që të reduktohen shpenzimet jo produktive duke u përqendruar mjetet në projekte të rëndësishme kapitale. Më pas Kryetarija ftoi Ministrin e Financave që ta shpjegojë më detalisht se çka përmban projektbuxheti i vitit 2011, sidomos të japë sqarime për rritjen e pagave, se a po zbatohet vendimi i Qeverisë apo jo, si dhe të tregojë se deri ku kanë arritur bisedimet me FMN-në, dhe a ka rrezik që të hyjmë në krizë buxhetore gjatë vitit 2011.

Bedri Hamza, informoi anëtarët që qysh në ditët e para të punës ia kanë dërguar një kërkesë FMN-së për ta dërguar një mision për diskutim të përbashkët të projektbuxhetit për vitin 2011 dhe FMN-ja e ka dërguar një mision. Ai tha që buxheti është vetëm një pjesë e programit me FMN-në dhe qysh në fillim janë marrë vesh që bisedat mund të zgjaten edhe më tepër se deri më datën 11 mars, mirëpo data 11 mars ka qenë paraprakisht e ditur se do të procedohet për aprovim në Qeveri. Ai shpjegoi se sa i përket pjesës së të hyrave buxhetore kemi një rritje prej 109 milionë € më tepër se sa ka qenë marrëveshja e tetorit, të cilat të hyra janë diskutuar në detale me FMN-në. Një pjesë e të hyrave ka të bëjë me rritjen e të hyrave në doganë dhe administratë tatimore, ndërsa një pjesë tjetër ka të bëjë me deklarimin e dividendes prej 45 milionë € nga kompanitë publike (40 milionë € nga PTK-ja dhe 5 milionë € nga Aeroporti). Ministri, po ashtu e dha një pasqyrë të shkurtër rreth **indikatoreve makroekonomikë** ku rritja ekonomike mesatare për periudhën 2011-2013 parashikohet të jetë 5.1 %, përderisa rritja ekonomike për vitin 2011 parashikohet të jetë 5.3 %, e ndikuar nga rritja e konsumit të investimeve dhe eksportit. Ai po ashtu tregoi që sa i përket pjesës së shpenzimeve për mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, të gjitha janë të harmonizuara me FMN-në. Kur jemi të çështja e pagave, ai tha që kanë pasur përafrim të qëndrimeve në raport me marrëveshjen e tetorit, mirëpo pritet që gjatë periudhës në vijim një raport që do ta hartojë misioni që ka qenë në Kosovë, të diskutohet në menaxhmentin e FMN-së dhe ta dërgojë te Bordi i FMN-së që të merren vendimet.

Sa i përket **mallrave dhe shërbimeve**, në marrëveshjen e tetorit ka qenë e paraparë vlera prej 193 milionë €, mirëpo në buxhet aktualisht janë 184 milionë € dhe arsyeja për zvogëlimin e këtij pozicioni është bërë për shkak se vitin e kaluar është përfshirë fondi për organizimin e zgjedhjeve të cilat janë paraparë të mbahen në vitin 2011, përderisa ato kanë ndodhur në vitin 2010. Ai në mes të tjerash sqaroi se **konsumi** gjatë vitit 2011 vlerësohet të rritet për 7.3 %, si rezultat i rritjes së konsumit të ekonomive familjare (të cilat parashikohen të rriten për 7.1 %) dhe konsumit publik (i cili parashikohet të rritet për 14.9 %). Kjo rritje i atribuohet rritjes së të ardhurave të disponueshme gjatë këtij viti që reflekton edhe rritjen e pagave për kategoritë e caktuara të shërbyesve civilë si dhe rritjen e të hyrave nga diaspora. **Investimet** gjatë vitit 2011 vlerësohen të rriten për 15.3 %, si rezultat i rritjes së investimeve publike për 25.6 % dhe të investimeve private prej 13.3 %. Rritja e investimeve publike ka të bëjë me vazhdimin e projekteve të rëndësishme infrastrukturore, ndërsa ajo e investimeve private ka të bëjë me përmirësimin e vazhdueshëm të parakushteve për zhvillim të biznesit si dhe të rimëkëmbjes së ekonomisë pas krizës ekonomike globale. Po ashtu edhe çmimet parashikohen të rriten mesatarisht 5.3 %, si pasojë e parashikimeve për rritjen e çmimeve botërore të ushqimit dhe naftës. Në vazhdim Ministri e dha një pasqyrë për **të hyrat buxhetore** të buxhetit të Kosovës, duke i cekur burimet e financimit të buxhetit siç janë: bartja nga viti 2010 në vitin 2011 që është 244 milionë € në bilancin bankar, të hyrat e rregullta për buxhetin e Kosovës, ku të hyrat parashikohen të jenë 1

miliardë e 60 milionë € (të hyrat vendore vlerësohen 261 milionë €, që shënojnë një rritje prej 18 % në krahasim me vitin 2010, të hyrat nga dogana 831 milionë € që janë 19 % më shumë se sa në vitin 2010, kthimet e tatimeve 31 milionë € dhe të hyrat jo tatimore 45 milionë € apo 10 % më shumë se sa në vitin 2010, të hyrat vetanake të komunave 58 milionë € që janë 7 % më shumë se sa në vitin 2010 dhe në nivelin qendror 55 milionë € që janë 2 % më shumë se sa në vitin 2010).

Ministri shpjegoi arsyet e kësaj rritjeje të planifikuar si dhe faktorët që kanë ndikuar duke cekur në mes të tjerash zhvillimet pozitive në ekonomi, ngritjen e nivelit të çmimeve në përgjithësi, rritja e pagave për kategoritë e caktuara të shërbyesve civilë, rritja e performancës së administratës në përgjithësi, implementimi i programit për pagesë të performancës, implementimi i fazës për avancimin e sistemit të teknologjisë informative, futja në përdorim e deklarimit elektronik, duke filluar nga tatimpaguesit, futja në përdorim e amendamentimit të Ligjit për TVSH-në që do të zvogëlonte prapë e regjistrimit nga shitja vjetore prej 50 mijë në 30 mijë, ngritja e njësive hetimore brenda administratës tatimore të Kosovës, fiskalizimi i bizneseve, ngritja e kapaciteteve të ATK-së, ngritja e numrit të inspektorëve tatimor dhe formimi i grupeve të përbashkëta me dogana, ATK-në dhe policinë për luftimin i informaliteteve. Ai gjithashtu prezantoi shkurtimisht **shpenzimet buxhetore** në të cilat pagat dhe mëditjet janë paraparë 383 milionë €, që shënon një rritje mesatare prej 23 % në krahasim me vitin 2010 në kuadër të së cilës është planifikuar implementimi i vendimit të Qeverisë të datës 6 janar 2011 për të gjitha kategoritë e premtuara. Disa kategori tjera që nuk kanë qenë pjesë e vendimit të Qeverisë siç është sistemi gjyqësor, mirëpo statusi i tyre është i rregulluar me ligje që bëhet nivelizimi i pagave të tyre, duke ditur që kryetari i Gjykatës Supreme ka pagën ekuivalente me atë të Kryeministrit. Sipas tij rritja e pagave nuk nënkupton vetëm përmirësim të pozitës materiale të të punësuarve, por nënkupton edhe rritje të produktivitetit dhe performancës. Ai sqaroi po ashtu se janë marrë veprime të nevojshme që të krijohen të hyra shtesë të cilat edhe janë krijuar dhe janë bërë ndryshime në strukturën e buxhetit ku janë bërë zvogëlime në mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere dhe pjesa e kapitaleve (pa i prekur pjesën e ekzekutimit të punimeve) të cilat janë akomoduar brenda nivelit të shpenzimeve në pajtim me FMN-në.

Sa i përket subvencioneve dhe transfereve, kemi ndryshime në strukturë që paraqesin një rritje për kategoritë sociale dhe zvogëlim për ndërmarrjet publike. Çëshjta e **financimeve shtesë**, ministri sqaroi se një pjesë e kësaj ka të bëjë me donacione duke shpjeguar që pjesa e FMN-së nuk është donacion por është kredi dhe nga 108 milionë sa kanë qenë, 22 milionë janë derdhur në fund të vitit 2010 në buxhetin e Kosovës dhe pjesa tjetër pritet varësisht nga vlerësimi i programit të vijë gjatë periudhës vijuese. Sa i përket fondeve të Komisionit Evropian, për periudhën e ardhshme makrofiskale deri në vitin 2013 kanë të parapara 150 milionë €, prej të cilave 30 milionë janë derdhur në fund të vitit 2010 në buxhetin e Kosovës, ndërsa pjesa tjetër varësisht prej zhvillimeve të vlerësimit të programit me FMN-në do të vijë në vijim, si dhe është e paraparë pjesa tjetër në vlerë prej 25 milionë € me Bankën Botërore me të cilën edhe është nënshkruar marrëveshja. Ministri sqaroi edhe shumën në vlerë prej 300 milionë €, të cilat mund të jenë nga një pjesë e privatizimit të PTK-së, privatizimit të distribucionit apo financim alternativ. Ai i informoi anëtarët që ngarkueshmëria e ekonomisë së Kosovës në relacionin GDP-borxhe është 7.5 %, përderisa shumica e vendeve të Evropës këtë ngarkueshmëri e kanë mbi 60 %. Sa i përket **bilancin bankar** është e paraparë në vlerë prej 476 milionë €, nëse do të rrjedhë çdo gjë sipas projeksioneve.

Albana Fetoshi, ngriti çështjen e të hyrave buxhetore, duke krahasuar disproporcionin e madhë në mes të të hyrave doganore (në shumën prej 831 milionë €), me të hyrat vendore që janë 261 milionë €, që do të thotë se ne do të mbijetojmë nga të hyrat doganore. Ajo gjithashtu theksoi se subvencionet në sektorin e bujqësisë janë parashikuar të kenë rritje vetëm për 2.7 milionë €, të cilat nuk janë të mjaftueshme për përmirësimin e gjendjes së këtij sektori. Po ashtu ngriti edhe çështjen investimeve kapitale nëpër komuna, konkretisht në komunën e Lipjanit që nuk është përfshirë asnjë projekt, që ndërlihet me zhvillimin ekonomik. Ajo ngriti edhe çështjen e realizimit të të hyrave hyrave vetanake

të komunave dhe ndarjes së shpenzimeve, duke cekur komunën e Zubin Potokut, të cilës i janë ndarë mbi 2 milionë €, ndërsa të hyrat vetanake të kësaj komune janë vetëm 7.800 €, apo komunës së Parteshit, i janë ndarë 1 milionë €, e që sipas saj kjo ndarje buxhetore është e dëmshme dhe do të përcillet me pasoja. Sa i përket privatizimit të PTK-së, përkujtojnë deklaratat e ish Ministri Shala, që PTK-ja do të shitet në vlerë prej 300-600 milionë €, ndërsa tani parashihet të shitet vetëm për 300 milionë €. PTK-ja është ndërmarrje publike dhe nuk mund të shitet për interesa të askujt, e aq më pak në një situatë të tillë që jemi, duke e ditur që buxheti i Kosovës merr 40 milionë € në vit nga kjo kompani.

Naser Osmani, veçoi si çështje më kryesore qëndrueshmërinë e buxhetit në përgjithësi, pasi që sipas tij është e vështirë t'ju besohet disa kategorive që janë paraparë të rriten, siç janë rritja e eksportit dhe investimeve, përderisa në Kosovë po ndodh ndryshe, pasi që nuk ka investitorë për shkak të politikave fiskale në përgjithësi. Jemi të varur më tepër nga importi dhe se eksportet tona janë të grupuara në dy deri tri kategori, që pothuaj janë të parëndësishme me këtë ekuivalencë të të hyrave dhe të dalave. Ai shprehu mendimin që është dashur Qeveria të ketë një strategji zhvillimore më afatgjatë, për të parë se cilat janë prioritetet e saja. Sa i përket privatizimit të PTK-së, pyeti Ministrin çka do të bëhet nëse nuk shitet PTK-ja, a ka Qeveria një variant tjetër se çka do të ndodhë nëse nuk shitet posta? Mendimi i tij ishte, që strategjia e shitjes së postës absolutisht nuk duhet të jetë pjesë e buxhetit. Ai theksoi që në mungesë të burimeve që do të tregojnë këtë qëndrueshmëri buxhetore do të vie deri te ngulfatja e bizneseve që do të jenë nën presion që t'i plotësojnë këto numra që janë dhënë. Sa i përket pagave, ai tha që Kosova ka nevojë për rritje të mirëqenies, mirëpo do të kishte qenë më e arsyeshme që kjo rritje të bëhet në një proporcion tjetër, gradualisht për dy deri tri vite. Shumat e rritjeve janë dhënë deri në 50%, por sipas kalkulimeve tregohet një rritje mesatare deri në 23%. Sipas tij, nëse prishen marrëdhëniet me FMN-në, atëherë ekziston rreziku që do të prishen marrëdhëniet edhe me donatorët tjerë pasi që gjërat kanë dalë prej kornizës afatmesme buxhetore, kështu që përgjithësisht ekziston frika që në vitet e ardhshme të kemi krizë buxhetore. Ai gjithashtu ngriti çështjen për mjetet e gatshme financiare të fondeve të Kosovës që mbahen jashtë Kosovës (mjetet e privatizimit) dhe sugjeroi Qeverinë që të lëviz në këtë drejtim që ato mjete të investohen në Kosovë.

Muhamet Mustafa, theksoi se Ministria e Financave duhet të punojë në disa drejtime lidhur me buxhetin, duke kërkuar që të gjitha kategoritë e të hyrave vendore të zbërthehen më detalisht, për të qenë më të sigurt që kjo rritje e të ardhurave buxhetore që është paraparë të rritet për 12.2%, si dhe rritja ekonomike 5.1%, do të ndodhë me të vërtetë. Sipas tij, ajo që e karakterizon këtë buxhet është se përmban prerje radikale shumë të mëdha, prandaj duhet t'i analizojmë të gjitha situatat për të qenë më të sigurt gjatë marrjes së vendimeve. Sa i përket rritjes së investimeve private për 13.4%, kërkoj argumente se prej nga do të vie kjo rritje kur mjedisi biznesor është kaq depresiv. Kemi një dalje jashtë kornizës afatmesme të shpenzimeve, prandaj është e nevojshme të bëhet rishikimi i tyre. Sipas tij, i gjithë problemi qëndron tek pasiguria e të ardhurave dhe duhet të shikohen aspektet zhvillimore të këtij buxheti, pasi që nuk ka prioritete konstante dhe i gjithë ky projekt nuk mund të bëhet vetëm me buxhet. Ai sugjeroi Qeverinë që të gjejë burimet alternative, e në radhë të parë përmes metodës së partneritetit publiko-privat.

Hykmete Bajrami, ngriti problemin e qëndrueshmërisë së buxhetit, lidhur me të hyrat e njëhershme të cilat përmbajnë vlerën e shitjes së PTK-së, përderisa sipas ekspertëve është shumë e vështirë që mjetet nga shitja e saj të inkasohen brenda një viti. Ajo tha që ne po presim për të marrë hua nga FMN-ja me një marrëveshje që ka shumë gjasa të prishet, e cila si pasojë do të sjellë edhe prishjen e marrëdhënieve edhe me donatorët tjerë. Gjithashtu tha që nuk janë përmbushë premtimet që janë dhënë gjatë fushatës elektorale për rritjen e pagave prej 50%, e që nga analiza që iu është bërë këtij buxheti, shifet se rritje është 23%. Lidhur me këtë, ajo tha që Qeveria nuk po mendon për të gjitha

shtresat e popullsisë, duke e ditur që çmimet po rriten dita ditës e sidomos ai i bukës, ajo pyeti Qeverinë se çfarë masa do të ndërmarrë që çmimi i bukës të mos rritet më? Sugjeroi që të ketë një strategji për stimulimin e sektorit privat për të ecur drejt një zhvillimi ekonomik afatgjatë.

Sali Asllanaj, vlerësoi të rëndësishme ruajtjen e marrëdhënieve të mira me FMN-në, rekomandimet e të cilave ndikojnë drejtpërdrejtë në donacionit nga jashtë, përfshirë organizatat ndërkombëtare financiare apo institucionet e Bashkimit Evropian. Sa i përket projektligjit, bëri vërejte për rritjen e madhë të numrit të punëtorëve në administratën publike si dhe për shpërndarjen jo do të drejtë të projekteve kapitale nëpër komuna.

Duda Balje, theksoi se buxheti që është para nesh duket për disa joreal, por për shumicën e parashikimet janë të mundshme që të realizohen. Megjithatë këtij buxheti i mungon korniza e buxhetit dhe strategjia fiskale, si dhe prioritetet e shpenzimeve, që të dihet politika në nivele të larta dhe shumë buxhetore, si dhe buxheti programore gjithashtu. Do të thotë na mungojnë informatat buxhetore, për qëllimet kryesore që Qeveria do të punojë. Në nenin 18, flitet për huat për entitetet e caktuara, në këtë drejtim pyeti se si shteti ka siguri që këto para do të kthehen, kur dihet se ndërmarrjet publike në vitet e fundit punojnë me bilancin negativ financiar? Sa i përket RTK-së, kjo ndërmarrje e madhe ka qenë publike, pastaj është vetëfinancuar, ndërsa vitin e kaluar ju i keni dhënë hua, pyetja është kush do të financoj RTK-në?

Bedri Hamza, në përgjigje të pyetjes për të hyrat nga doganat, theksoi se të hyrat nga doganat që nga pavarësimi i Kosovës kanë qenë të hyrat më të shumta, ndërsa po bëhet përpjekje të ndryshohet statistika e të hyrave, në favor të të hyrave të brendshme. Kjo ka ardhur si rezultat i përmisimit të efikasitetit të ATK-së dhe AD, që për rezultat vetëm në dy muajt e parë të këtij viti, kemi i inkasimi më të madh të të hyrave, krahasuar me vitin e kaluar dhe kjo në përputhje dhe në zbatim të ligjit. Subvencionet në bujqësi janë rritur për 50%, kur dihet se ky sektor do të mbështet edhe përmes granteve nga donacionet nga jashtë. Sa i përket pyetjes për shpenzimet kapitale në Komunën e Lipjanit, buxheti i komunave përgatitet me ligjin për financat e pushtetit lokal, në bazë të prioritetëve që i përcaktojnë ato dhe ato janë pjesë e tabelave të buxhetit total. Ndërsa ndarja e buxhetit për komunat, bëhet në bazë të formulës së ndarjeve të gradeve, që është përcaktuar me ligjin e lartpërmendur. Të hyrat vetanake të cilat secila komunë i mbledh i deponon në një llogari të thesarit dhe ato i kthehen komunës. Sa i përket çështjes së privatizimit të PTK-së, Qeveria se asnjë herë nuk ka paragjyqur vlerën të cilën mund ta mbërrinin në treg. Për çështjen e qëndrueshmërisë fiskale, theksoi se jemi shumë të përgjegjshëm dhe nevojitet një punë ditore me një përkushtim të jashtëzakonshëm, për tu arritur projeksionet buxhetore. Rreth bisedave me FMN për rritjen e pagave janë harmonizuar qëndrimet dhe kemi dallime vetëm 11 milion € dhe në takimet që do të kemi me përfaqësuesit e FMN-së, do të bëjë përpjekje që të mbesim në programin e nënshkruar. Çështja e kthimit të parave të privatizimit, është nevojë e domosdoshme të bëhet amendamentimi i ligjeve për të mundësuar investimin e këtyre mjeteve në Kosovë. E njëjtë situatë vlenë edhe për parat e trustit. Për rritjen e investimeve private do të tregohen në KASH-in që do të dorëzohet Kuvendit. Sa i përket pyetjes për zvogëlimin e administratës publike, do të bëhet përpjekje që me pensionimet që do të ndodhin, të zëvendësohen me punëtorët aktual. Për Radiotelevizionin e Kosovës në mungesë të një zgjidhje të financimit, këtë vit janë ndarë mjete nga buxheti, kërkoi nga Kuvendi të gjindet mënyra e financimit të këtij mediumi publik, që financimi të mos jetë përmes buxheti. Sa i përket kredisë së KEK-ut, pritet të jetë viti fundit i kreditit të kësaj ndërmarrje dhe kthimi i kredive do të fillojë në vitin 2013.

Hykmete Bajrami, duke u ndërlidhur me koston për rritjen e pagave, theksoi se në fillim është parashikuar që kostoja në emër të premtimeve të jetë 140 milion €, ndërsa në këtë draft shifet se për

këtë qëllim janë ndarë 72 milion €, dhe nëse e krahasojmë në përqindje i bie sa ka rritje prej 23%. Edhe rritja që është premtuar për arsimtarët, ndoshta është bërë në rrogën bazë, kur nëpunësit e kanë nënshkruar kontratën, që ka qenë një bazë më e vogël dhe si rezultat rroga nuk po rritet siq është premtuar 50%. Premtimet për ngritjen e pagave, janë reflektuar me rritjen e qmimeve, e që i godet të gjitha shtresat, edhe ata që nuk janë të punësuarë.

Albana Fetoshi, duke u ndërlidhur me përgjigjet e ministrit, theksoi se nuk e ka ngritur çështjen se sa do të ketë transparencë për shitjen e PTK-së, për arsye se PTK-ja nuk duhet të shitet, kur dihet se 40 milion të hyra nga kjo ndërmarrje, shkojnë buxhetin e Kosovës. Sa i përket çështjes së uljes së importit, thash që duhet të përcillet me rritjen e prodhimit, dhe në këtë drejtim asgjë nuk po bëhet në këtë drejtim. Nuk mund të rritet eksporti nëse nuk rritet prodhimi.

Bedri Hamza, në pyetjen për pagat, njoftoi se rritja është bërë duke respektuar vendimin e Qeverisë. Psh. për punëtorët shëndetësor që është paraparë rritje prej 30%. Në rast një punëtor ka pasur rrogën 200€, përmes rritjes 30% i shtohen 60€ dhe rroga bëhet 260€. Plus shtesat 44 € që i kanë pasur, dhe në total del 304€.

Kryetarja, falënderoi ministrin dhe gjithë koleget për vërejtjet e sugjerimet e tyre dhe konsideroj që shumë prej këtyre vërejtjeve kanë qenë te arsyeshme. Propozojë që Komisioni të rekomandojë Kuvendit se projektligji për buxhetin për vitin 2011 dhe parashikimet e tjera i plotësojnë kushtet për tu shqyrtuar dhe miratuar në Kuvend dhe i njëjti të miratohet në parim.

Naser Osmani, propozojë që Komisioni të rekomandojë që Projektligji të shqyrtohen në seancë plenare dhe mos të rekomandojmë që të aprovohet. Nuk duhet të prejudikojmë diçka që faktikisht do të merremi pas leximit të parë. Do të duhej të merrej edhe pëlqimi i grupeve parlamentare. Prandaj Komisioni realisht duhet të jap kontributin me rastin e amendamentimit të tij.

Kryetarja, me qenë se edhe përfundimi i Kryesisë së Kuvendit na ngarkon që ti rekomandojmë Kuvendit për miratimin apo mosmiratimin e projektligjit në parim, ne do të duhej të bënim një rekomandim në këtë drejtim. Propozojë që Komisioni të rekomandojë Kuvendit miratimin e projektligjit në parim.

Kryetarja, konstatoi se pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni me **gjashtë** vota “për” (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje dhe Muhamet Mustafa), dy “kundër” (Naser Osmani dhe Albana Fetoshi) dhe dy “abstenime” (Sali Asllanaj dhe Xhevdet Neziraj), nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. I rekomandon Kuvendit që në shqyrtimin e parë, të miratojë në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Mbledhja përfundoi në orën 12:55

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ